



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 8 prill 2011

Nr. i rastit 2010-01

Z. Kazagic Djeljalj

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 prill 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues i Panelit
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Z. Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, paraqitur në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Koncepti Llogaridhënës i EULEX-it i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Ankesa ishte regjistruar më 2 shtator 2010. Informatë shtesë ishte kërkuar nga parashtuesi i ankesës me datën 6 tetor 2010. Kjo informatë e tillë ishte pranuar me datën 19 tetor 2010.
2. Me 8 dhjetor 2010, Paneli ka vendosur që ta njoftoj Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë, duke ftuar atë që të dorëzoj me shkrim vërejtjet lidhur me ankesën. Gjithashtu ishte vendosur që ta shqyrtoj bazueshmërinë e kërkesës, si dhe pranueshmërinë e saj, ku zbatohet Rregulla 30, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores së Punës së Panelit (më pas si RrP).

3. Vërejtjet e ShM janë marrë me datën 21 janar 2011, pasi ato ishin përkthyer dhe dërguar tek parashtruesi i ankesës për vërejtje shtesë nga ai.
4. Më 9 shkurt 2011 parashtruesi i ankesës ka dërguar vërejtjet e tij shtesë, të cilat ishin dërguar tek ShM për njoftim.

FAKTET

I. RRETHANAT E RASTIT

Parathënie

5. Më 29 shkurt 1984 parashtruesi i ankesës dhe vëllai i tij kishin nënshkruar një kontratë për një ndërtim të përbashkët të një shtëpie në Mitrovicë, në një parcelë toke e regjistruar në emrin e vëllait. Ata ishin pajtuar se pas ndërtimit të shtëpisë, ata do të kishin të drejta të barabarta në parcelë dhe shtëpi, dhe se pas regjistrimit të parcelës dhe shtëpisë në librin e kadastrës do të kryhej ndarja e parcelës.
6. Më 11 shtator 2002, Zyra Komunale Kadastrale e Mitrovicës, nën Administrimin e UNMIK-ut, i kishte lëshuar një listë poseduese, përfshirë shtëpinë, oborrin dhe rrugën private personit M.K., një prej të afërmeve të parashtruesit të ankesës, i cili nuk është pronar i pronës në fjalë.
7. Më 24 shkurt 2005, personi M.K. dhe Banka Ekonomike në Prishtinë (me vonë Banka) kishin arritur një marrëveshje kredituese për 50,000 Euro (EUR). Vëllai i parashtruesit të ankesës ishte përfshirë në dokumentet e kredisë si bashkë-nënshkrues i kredisë, pa dijeninë tij.
8. Më 11 mars 2005, Gjykata Komunale kishte vërtetuar marrëveshjen hipotekare midis Bankës dhe personit M.K. përfshirë vëllain e parashtruesit të ankesës si bashkë-nënshkrues të kredisë.
9. Më 14 mars 2005, Zyra Kadastrale Komunale në Mitrovicë kishte miratuar shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të parashtruesit të ankesës (me vlerë prej 120,000 EUR) si hipotekë në kredinë e bankës në fjalë bazuar në kërkesën e bërë nga personi M.K. Një kërkesë për rishqyrtimin e vendimit mund të ishte dorëzuar brenda 30 ditëve. As parashtruesi i ankesës e as vëllai i tij, bashkëpronari i pronës nuk ishin njoftuar për ndonjërin prej këtyre çështjeve në atë kohë. M.K. nuk posedon asnjë pjesë të pronës në fjalë.
10. M.K. nuk ka paguar këstin e kredisë me kohë. Për shkak të mos pagesës, afati i fundit për pagesën e tërë kredisë ishte data 1 shkurti 2006.
11. Më 3 shkurt 2006, Banka kishte dërguar një kërkesë tek Gjykata Komunale e Mitrovicës që të ekzekutohej marrëveshja për kredi duke

autorizuar vendosjen në ankand të pronës së parashtruesit të ankesës. Kredia e papaguar kishte arritur diku 49,200 EURO.

12. Më 9 shkurt 2006 Gjykata Komunale kishte lëshuar një Vendim rreth kërkesës. Përmbajtja e saktë e atij Vendimi nuk dihet.

Procedurat Civile dhe Administrative

13. Më 19 nëntor 2007, Gjykata Komunale e Mitrovicës e kishte njoftuar parashtruesin e ankesës në lidhje me procedurat gjyqësore kundër pronës së tij në formë të kërkesës për një deklaratë. Kjo ishte hera e parë që parashtruesi i ankesës apo vëllai i tij kishin dëgjuar diçka në lidhje me marrëveshjen kreditore, dhe për faktin se shtëpia e tyre ishte duke u shfrytëzuar si hipotekë për kredinë e një personi tjetër.
14. Parashtruesi i ankesës nuk kishte marrë një kopje të Vendimit të datës 9 shkurt 2006 ashtu siç duhej të bënte, me gjasë duhej të binte dakord rreth gjetjeve në Vendim dhe të nënshkruante në te, dhe se ai frikësohej se në këtë mënyrë do ta humbiste pronën e vet. Në vend të kësaj, ai pretendon se ka shkuar menjëherë në polici dhe kishte kërkuar hetimin e kësaj çështje (shih më poshtë paragrafin 23).
15. Më 11 dhjetor 2007, Gjykata Komunale ka marrë një letër nga parashtruesi i ankesës duke kërkuar që kërkesa për përmbartim të hedhet poshtë dhe të hiqet shfrytëzimi i pasurisë së tij si hipotekë.
16. Më 14 dhjetor 2007, Gjykata Komunale pezulloj ekzekutimin e vendimit të 9 shkurt 2006, dhe vendosi që propozimi për ekzekutim i bërë nga Banka të konsiderohej si padi. Nuk kishte mundësi të bëhej ankesë kundër vendimit të datës 14 dhjetor 2007.
17. Zyra Komunale Kadastrale ishte njoftuar rreth këtij vendimi përmes një letre nga kryetari i Gjykatës Komunale të Mitrovicës më 21 dhjetor 2007. Kjo letër ka shpjeguar se vëllai i parashtruesit të ankesës nuk kishte nënshkruar marrëveshjen për ta regjistruar pronën e tij si hipotekë, dhe se Gjykata Komunale kishte vendosur të anuloj ekzekutimin e vendimit të lëshuar më 9 shkurt 2006.
18. Pasi nuk u ndërmor asnjë veprim në lidhje me ekzekutimin e vendimin përfundimtar të Gjykatës së datës 14 dhjetor 2007, dhe se prona e parashtruesit të ankesës kishte vazhduar të mbetej si hipotekë për kredinë, parashtruesi i ankesës, më 4 shkurt 2008 i dërgoi një letër Kryetarit të Komunës së Mitrovicës. Ai kërkoi që autoritetet vendore të veprojnë në përputhje me vendimin e Gjykatës, të ndalojnë shfrytëzimin e pasurisë së tij si hipotekë dhe ta shpallin aktvendimin e 9 shkurtit 2006 si të pavlefshëm.
19. Më 12 Maj 2008, parashtruesi i ankesës ka dërguar të njëjtën letër Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit, duke ia dërguar një kopje edhe Drejtorit të Zyrës Kadastrale dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës. Ai ka marrë një përgjigje më 15 korrik 2008 nga Zyra Kadastrale Komunale se kërkesa e tij ishte hedhur poshtë, sepse ai nuk kishte

ndonjë bazë ligjore për kërkesën e tij dhe ai nuk ka dhënë ndonjë dëshmi nga banka se prona në fjalë është nuk pretendohet nga askush. Ai ishte këshilluar se ai mund të ankohej kundër këtij vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të saj. Vërtetimi mbi pranimin e saj ishte nënshkruar nga gruaja e personit M.K. më 16 korrik 2008 dhe nga parashtruesi i ankesës më 24 shtator 2008.

20. Më 14 tetor 2008, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, parashtruesi i ankesës paraqiti ankesë tek Drejtori i Administratës dhe Personelit, sipas udhëzimeve, që personat që ishin përfshirë të ndëshkohen dhe se vendimi i paligjshëm për të shfrytëzuar pronën e tij si hipotekë të shfuqizohej. Pasi ai nuk mori ndonjë përgjigje, ai dërgoi Drejtorit një letër të re më 11 mars 2009.
21. Më 19 mars 2009, më në fund parashtruesi i ankesës ka marrë një përgjigje nga Drejtoria e Administratës dhe Personelit. Përgjigja thoshte se pasi ai nuk kishte marrë një përgjigje për ankesën e tij brenda 30 ditëve, ashtu siç ai duhej ta bënte në bazë të Ligjit mbi Procedurën Administrative, ai nuk kishte të drejtë të iniciante procedurë administrative në Gjykatën Supreme të Kosovës (Paragrafi 131.1 i Procedurës Administrative). Ai gjithashtu u njoftuar se që nga 20 qershori 2008, në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, organ i shkallës së dytë për tu ankuar ishte Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe se më nuk ishte Drejtori i Administratës dhe Personelit.
22. Më 22 qershor 2009, parashtruesi i ankesës kërkoi që Agjencia Kadastrale e Kosovës të shfuqizoj regjistrimin e pronës së tij si hipotekë.

Procedurat penale

23. Pas marrjes së informatës me datën 19 nëntor 2007 rreth vendimit të datës 9 shkurt 2006, parashtruesi i ankesës pretendon të ketë shkuar menjëherë në polici dhe të ketë kërkuar hetime rreth çështjes. Deklaratat ishin dhënë dhe rasti ishte përcjellë tek prokurori. Parashtruesi i ankesës më vonë kishte mësuar se dokumentet e rastit kishin humbur/harruar/shkatërruar në gjykatë. Kopje të reja të dokumenteve duhej të merreshin nga dosjet e hetimeve të policisë për tek t'iu dhënë prokurorëve. Supozohet se procedurat ishin ndërprerë nga trazirat në Mitrovicë, që si për pasojë kishin mbyllur gjykatën deri në një njoftim tjetër.
24. Më 30 qershor 2008, parashtruesi i ankesës kërkoi nga prokurori publik në Prishtinë të ndërmarrë veprime kundër disa njerëz të përfshirë në krimin e organizuar që i kishin shkaktuar dëm atij, vëllait të tij dhe bankës. Përveç kësaj, ai kërkoi që vendimi fillestar i Gjykatës Komunale për regjistrimin e pronës së tij si hipotekë të shfuqizohej; që kontrata e kredisë të shfuqizohej dhe se keqbërësit të ndëshkohen ashpër.

Përfshirja e EULEX-it

25. Më 25 qershor 2009, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga prokurori i EULEX-it në Mitrovicë të vazhdoj hetimin penal dhe ndjekjen penale në lidhje me personin M.K. dhe të tjerët, të shfuqizohej vendimin e Zyrës për Kadastër të datës 14 mars 2005 për regjistrimin e vendimit të pronës si hipotekë dhe të anulohet kontratën e kredisë ku vëllai i parashtruesit të ankesës paraqitet si bashkë-nënshkrues. Ky rast është regjistruar si rasti me numër 07/09 i datës 25/06/2009. Parashtruesit të ankesës i ishte thënë që të pres një përgjigje pas rreth katër muajve.
26. Pas disa përpjekjeve të dështuara për të marrë ndonjë informacion rreth statusit të rastit të vet, parashtruesi i ankesës dhe vëllai i tij më në fund u takuan me prokurorin e EULEX-it, të cilit iu kishte caktuar rasti në prill 2010. Atyre iu thanë të presin derisa prokurorët t'i kontaktojnë ata. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të përsëritura që t'i takojnë prokurorët, që atëherë ata nuk kanë arritur të marrin ndonjë njoftim tjetër rreth rastit të tyre.

Procedurat në pritje

27. Tani për tani, sipas parashtruesit të ankesës, katër procedura të ndara janë në pritje lidhur me pasurinë e parashtruesit të ankesës:
 - Në gjykatën e Mitrovicës, numri i rastit 2007-BA-528, datë 4 janar 2008. Në pritje të rihapjes së gjykatës.
 - Në polici apo prokurorinë publike në Prishtinë, përmes njësisë së hetimit të krimit ekonomik, datë 30 qershor 2008.
 - Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, dorëzuar më 22 qershor 2009, me nr. të protokollit 03.817.09. Kërkesa për rishikim dorëzuar gjithashtu më 7 shtator 2009, siç është udhëzuar; dhe
 - Te prokurori i EULEX-it në Mitrovicë, dorëzuar më 25 qershor 2009, numri i rastit 09/07.
28. Përveç kësaj, në Gjykatën Komunale të Mitrovicës ende nuk është vendosur për procedurat civile që supozohet se kanë mbetur pezull sipas vendimit të datës 14 dhjetor 2007.

Informatë rreth vëllimit të lëndëve në gjykatat e Mitrovicës

29. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka publikuar një raport në janar 2011, të titulluar "Sistemi i Drejtësisë në Mitrovicë: Statusi i rifreskuar dhe shqetësimet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Raporti paraqet hollësisht vështirësitë dhe vëllimin e rasteve të pazgjithura para prokurorëve dhe gjykatave në Mitrovicë.
30. Raporti i OSBE-së paraqiti se gjykatësit dhe prokurorët vendor nuk kanë pasur qasje në kompleksin e gjykatës në Mitrovicë që prej marsit 2008 si pasojë e trazirave dhe ngjarjeve që pasuan. Kompleksi i

gjykatës është administruar nga stafi i EULEX-it që prej dhjetorit 2008. Gjykatësit dhe prokurorët vendorë janë zhvendosur në zyrat e gjykatës komunale të Vushtrrisë, ku vazhdojnë të punojnë në rrethana të vështira.

31. Nga korriku 2009 e tutje, EULEX-i ka bërë inventarizimin e rasteve të pazgjidhura dhe ka gjetur disa si raste me përparësi. Sipas inventarizimit, aty ishin 3500 raste të pazgjidhura në Gjykatën e Qarkut dhe 5200 raste të tjera të pazgjidhura tek prokurorët. Numri i rasteve të pazgjidhura ishte 4600 dhe 3893 raste në Gjykatën Komunale dhe prokurori përkatësisht.
32. Në mënyrë që të vlerësohet vëllimi i rasteve që vazhdimisht është duke u rritur, duhet të theksohet se nga shkurti 2008 deri në tetor 2010 Gjykata Komunale ka kryer 46 raste penale dhe 484 raste civile. Nga dhjetori 2008 e deri në tetor 2010 EULEX-i kishte përfunduar 40 raste penale që bien brenda mandatit të tij në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.

II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

33. Pjesët përkatëse të shkëputura nga Neni 2 dhe 3 i Veprimit të Përbashkët të Këshillit Evropian 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), thotë si në vijim:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikatat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

...

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar / ekonomik dhe krimeve tjera serioze të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

(e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;

(f) të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

Ligjit mbi Kompetencat

34. Ligji për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, në tekstin e mëtejme: Ligji për kompetencat), dhe më konkretisht nenet e saj 5, 7 dhe 8 rregullojnë integrimin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Neni 5 Kompetenca e gjyqtarëve të EULEX-it për lëndët civile

5.1 Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë civile do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi, në pajtim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it për:

...

c) çdo lëndë të re apo lëndë të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën, përfshirë këtu ekzekutimin e procedurave që janë në juridiksion të cilësdo gjykatë në Kosovë, nëse:

(i) ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; apo

(ii) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paaftë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo

(iii) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

Neni 7 Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të PSRK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ata janë caktuar nga Kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

Neni 8 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të PSRK-ës sipas ligjit mbi themelimin e PSRK-në, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

LIGJI

I. PRANUESHMËRIA

E përgjithshme

35. Para shqyrtimit të ankesës rreth bazueshmërisë së saj, Paneli duhet të vendos nëse do të pranojë atë për shqyrtim, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të RrP-së.

36. Ankesa është dorëzuar në Panel më 2 shtator 2010, pra brenda tre muajve nga data kur Paneli mund t'i pranojë ankesat (8 qershor 2010) siç është përcaktuar në Rregullën 25 paragrafi 3.
37. Nuk është bërë asnjë vërejtje nga palët sa i përket pranueshmërisë së ankesës.
38. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i të Kosovës gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv përfshinë çështje të caktuara që kanë të bëjnë me policinë, gjyqësinë dhe doganat. Paneli nuk do të shqyrtojë procedurat gjyqësore para gjykatave të Kosovës.

Ankesat specifike

Procedurat penale të janarit 2008

39. Në lidhje me procedurat penale të pazgjdhura në Gjykatën Komunale / Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës që nga janari 2008, Paneli vë në dukje se sipas Rregullores 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli rithekson se mund të shqyrtojë vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv, të përmendura më sipër.
40. Rasti për të cilin ankuesi i referohet është i pazgjdhur në një gjykatë në Kosovë. Nuk është treguar apo edhe argumentohet se ndonjë gjykatës i EULEX-it ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në rastin e parashtruesit të ankesës.
41. Si pasojë, çështjet që janë ngritur në këtë pjesë të kësaj ankese nuk bien në mandatin ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Prandaj Paneli ka gjetur çfarëdo ankese që lidhen me këto procedura penale si të papranueshme.

Procedurat penale të iniciuara më 30 qershor 2008

42. Në lidhje me procedurën penale që është e pazgjdhur në polici ose në prokurorinë publike në Prishtinë që nga 30 qershori 2008, Paneli vë në dukje se garancionet për një proces të drejtë të sanksionuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: Konventa) nuk zbatohen për procedurat penale në lidhje me të drejtën që palët e treta të ndiqen penalisht apo të dënohen për ndonjë vepër penale (*shih Perez v. France* [GC], nr. 47287/99, § § 57-72, KEDNj 2004-I).
43. Ashtu si në rastin konkret, parashtruesi i ankesës kishin dashur të iniciohen procedura penale ndaj palës së tretë, në lidhje me këto procedura Paneli gjeti ankesat të papranueshme.

Procedurat në Agjensionin Kadastral të Kosovës

44. Siç është cekur nga vërejtjet e Shefit të Misionit, procedurat në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të natyrës administrative,

prandaj ato nuk janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, siç përcaktohet me Rregulloren 25, paragrafin 1 të Rregullores së Punës. Prandaj lidhur me këto procedura Paneli i gjen këto ankesa të papranueshme.

Procedura civile në Gjykatën Komunale të Mitrovicës dhe procedura penale në prokurorinë e EULEX-it

45. Në lidhje me procedurën civile që është e pazgjidhur në Gjykatën Komunale të Mitrovicës, si rezultat i vendimit përfundimtar të 14 dhjetorit 2007, ShM supozon se ato lidhen me mosmarrëveshjen mbi verifikimin e marrëveshjes së hipotekës. Ai parashtroi se këto procedura mund të thuhet se bie në kuadër të mandatit të ekzekutivit të EULEX-it.
46. Lidhur me procedurën penale të pazgjidhur në prokurorinë e EULEX-it në Mitrovicë që prej 25 qershorit 2009, ShM ka paraqitur se nuk mund të përjashtohet se hetime të mëtejshme mund të çonin në përfundimin se ishte kryer vepra penale e mashtrimit (neni 261 KPK MM: KËTU EMRI I PLOTË). Kjo mund të bie në kompetencë dytësore të prokurorisë së EULEX-it.
47. Duke pasur parasysh këto, këtë pjesë të ankesës Paneli e gjen të pranueshme.

II. SHKELJE E SUPOZUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS DHE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

Ankesat

48. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës pohon se mos-ekzekutimi i vendimit përfundimtar ligjërisht i detyrueshëm i datës 14 dhjetorit 2007, ka shkelur të drejtat e tij të garantuar me nenin 6 të Konventës. Në fakt kjo gjithashtu i referohet procedurës civile se, për sa është i njoftuar Paneli, ende nuk është marrë për shqyrtim në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.
49. Për më tepër, ai ankohet se nuk ka pasur asnjë përparim, çfarëdo qoftë ajo, në hetimin e iniciuar nga prokurori i EULEX-it pas kërkesës së parashtruesit të ankesës që të sqarohen rrethanat e rastit i cili është paraqitur në qershor 2009.
50. Dispozita përkatëse e Konventës vijon si më poshtë:

Neni 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...

51. Parashtruesi i ankesës gjithashtu pohon se iu është shkelur e drejta e tij për gëzimin e qetë të pasurisë së tij, garantuar sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.
52. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës për pjesët e saj përkatëse thotë si në vijim:

Neni 1 Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

...

Dokumentet e paraqitura nga palët

53. Përmes dokumenteve të paraqitura, ShM vëren se në mënyrë që të ekzekutohet vendimi i detyrueshëm ligjor i datës 14 dhjetor 2007, Gjykata Komunale e Mitrovicës duhet të kryej procedurën civile, e cila është iniciuar nga Banka Ekonomike me qëllim të shitjes së pronës në fjalë. Në këto procedura, parashtruesi i ankesës do të ishte në gjendje të kontestonte përdorimin e kësaj prone si hipotekë. Këto procedura nuk kanë filluar ende.
54. Për më tepër, ShM pranon se, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Gjykata”), fakti se gjykimi i datës 14 dhjetorit 2007 ende nuk është zbatuar pas më shumë se tri viteve, mund të ketë privuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës prej të gjitha efekteve të dobishme.
55. Në lidhje me ankesën sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, ShM pohon se përderisa të drejtat e parashtruesit të ankesës mbi pronën e kontestuar bien në nocionin e gjerë të “pasuritë” brenda kuptimit të kësaj dispozite, sa i përket Konventës nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në të drejtat e tij.
56. ShM argumenton se vendimi i datës 14 dhjetor 2007 ka ndërprerë vetëm ekzekutimin e vendimit të mëparshëm, atë të datës 9 shkurt 2006. Megjithatë, pasi shfrytëzimi i pronës së parashtruesit të ankesës si hipotekë nuk është ndërprerë, e drejta e tij për ta shfrytëzuar atë pronë mund të ketë qenë e kufizuar. Për më tepër, pasi procedurat civile në këtë drejtim nuk kanë filluar ende, kjo mund të çojë në paqartësi ligjore në lidhje me gjendjen juridike të pronës.
57. Megjithatë, ShM i EULEX-it ishte njoftuar rreth këtij rasti vetëm më 25 qershor 2009, kur parashtruesi i ankesës i kërkoi prokurorit të EULEX-it në Mitrovicë për të vazhduar me hetimin penal, ndjekje penale dhe me shfuqizimin e vendimit të gjykatës për regjistrimin e pronës si hipotekë, si dhe kontratën e kredisë.
58. Parashtruesi i ankesës nuk ka bërë komente të veçanta rreth vërejtjeve të ShM.

Vlerësimi i Panelit

E përgjithshme

59. Paneli vëren se ankesa e tanishme është një shembull i mirë i një rasti që është lënë në gjendje të paqartë juridike për shkak të mos funksionimit të sistemit të gjykatave në Mitrovicë. Duke pasur parasysh numrin në rritje të rasteve të pazgjydhura në gjykatat në Mitrovicë, fatkeqësisht, nuk duket se ky rast, në ndonjërin prej procedurave ku parashtruesi i ankesës është përfshirë, do të shqyrtohet së shpejti.

Neni 6 i Konventës - mos ekzekutimi

60. Paneli vëren se vendimi i Gjykatës komunale i datës 14 dhjetorit 2007 është përfundimtar dhe detyrues. Deri më sot, autoritetet nuk kanë marrë masa për të zbatuar këtë vendim në të mirë të parashtruesit të ankuesit, pavarësisht prej kontakteve të tij të përsëritura me autoritete të ndryshme. Zyra Kadastrale Komunale e cilëson pronën në fjalë se është në hipotekë. Rasti civil, përmes së cilit Banka kërkon që prona të nxjerrët në ankand, është ende në pritje para Gjykatës Komunale të Mitrovicës, ku nuk është ndërmarrë asnjë veprim që nga dhjetori 2007. Duket se parashtruesi i ankesës nuk ka mënyra të tjera për ta liruar pronën nga hipoteka sipas ligjit në fuqi.

61. Paneli përsërit praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për efektin që e drejta për qasje në një gjykatë e garantuar sipas Nenit 6 § 1 të Konventës do të ishte iluzore nëse sistemi i brendshëm juridik ka lejuar një vendim përfundimtar, detyrues ligjor të mbetet i pazbatueshëm në dëm të njëjës palë. Ekzekutimi i një vendimi lëshuar nga çfarëdo gjykate duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “gjykimit” si në Nenin 6 (mes tjerash shih *Hornsby kundër Greqisë*, aktgjykim i datës 19 mars 1997, Raportet 1997-II, fq. 510-11, §§ 40 etj.).

62. Paneli konsideron se edhe pse problemet e hasura nga parashtruesi i ankesës për fat të keq janë të zakonshme, sidomos në rajonin e Mitrovicës, kjo nuk e heq detyrimin që të përmbushen kriteret e përcaktuara sipas Nenit 6 të Konventës në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të parashtruesit të ankesës.

Zbatimi i Nenit 1 të Protokollit 1 rreth rrethanave të rastit

63. Paneli vëren se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, koncepti i “pronësisë” në pjesën e parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ka një kuptim të pavarur, i cili është i pavarur prej klasifikimi formal në ligjin vendor (*Anheuser-Busch Inc kundër Portugalisë [GC]*, § 63; *Öneryildiz kundër Turqisë [GC]*, § 124; *Broniowski kundër Polonisë [GC]*, § 129; *Beyeler kundër Italisë [GC]*, § 100; *Iatridis kundër Greqisë [GC]*, § 54).

64. Koncepti i “pronësisë” i përmendur në pjesën e parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ka një kuptim të pavarur, i cili nuk kufizohet në pronësinë e mallrave fizike dhe është i pavarur prej klasifikimit formal

në ligjin vendore: të drejtat e tjera të caktuara dhe interesat që përbëjnë asetet mund të konsiderohen si “të drejtat pronësore” dhe kështu konsiderohen si “pronësi” si në këtë dispozitë. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast është nëse rrethanat e çështjes, të cilësuar si tërësi, iu janë dhënë parashtruesit të kërkesës për një interes të përgjithshëm të mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (*shih latridis kundër Greqisë, aktgjykimi i cituar më sipër*; *Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202/96, § 100, KEDNj 2000-I; dhe Broniowski kundër Polonisë [GC], nr 31443/96, § 129, KEDNj 2004-V*).

65. Në rastin në fjalë, Paneli vëren se në bazë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga parashtruesi i ankesës, vëllai i tij zotëron pronën në fjalë. Ata arritën një marrëveshje në bazë të të cilës ata së bashku financuan dhe ndërtuan një shtëpi në parcelën e tokës në fjalë. Paneli konstaton se në rrethanat e rastit, parashtruesi i ankesës kishte interes substancial të mjaftueshëm për t’i dhënë atij të drejta të cilat duhet të konsideroheshin si “pronësi” në kuptimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Ndërhyrja

66. ShM argumenton se aty nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të ankesës.
67. Paneli kujton praktikën gjyqësore të Gjykatës në faktin se pamundësia e një parashtruesi të kërkesës të siguroj ekzekutimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës në të mirë të tij ose të saj përbën një ndërhyrje në të drejtën e gëzimit të qetë të pronësisë, siç është përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (midis shumë autoriteteve të tjera shih *Burdov kundër Rosisë, nr. 59498-00, § 40, KEDNj 2002-III*).
68. Për më tepër, në vlerësimin e respektimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata e bën një shqyrtim të përgjithshëm të interesave të ndryshme në këtë çështje, duke pasur parasysh se Konventa ka për qëllim të mbrojë të drejtat që janë “praktike dhe efektive”. Në këtë kontekst, është theksuar se pasiguria - qoftë ajo legjislative, administrative apo që dalin nga praktika të zbatuara nga autoritetet - është një faktor që duhet të merret parasysh në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve zyrtare. Në të vërtetë, nëse një çështje me interes të përgjithshëm është në rrezik, atëherë ajo është detyrë e autoriteteve publike për të vepruar brenda një afati të duhur, në një mënyrë të përshtatshme dhe të vazhdueshme (shih *Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202/96, § §§ 110 përmbledhje, 114 dhe 120 përmbledhje, KEDNj 2000-I; Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr 48553/99, § § 97-98, KEDNj 2002 VII; dhe Plechanow kundër Polonisë, nuk 22279/04, §. 102, 7 korrik 2009*).
69. Për më tepër, kjo vonesë në regjistrimin e një situatë ligjore lidhur me pronësinë mbi tokën themeluar nga gjykatat vendore është konsideruar si një ndërhyrje në të drejtën e gëzimit të qetë të pronësisë nëse ajo shkakton një gjendje të pasigurisë në realizimin e

të drejtave pronësore (shih *Georgi Marinov kundër Bullgarisë*, nr. 36103/04).

70. Paneli nuk pajtohet me interpretimin e ShM rreth ndërhyrjes në rastin e tanishëm. Është e vërtetë se parashtruesi i ankesës nuk ka humbur kontrollin fizik të pronës. Sidoqoftë, e drejta e tij për ta kontrolluar dhe për ta gëzuar atë pronë në mënyrë të qetë është penguar si pasojë e një sërë fakteve si në vijim. Së pari, pasuria është shfrytëzua si hipotekë për një kredi bankare të marrë nga pala e tretë, pa dijen e parashtruesit të ankesës. Së dyti, pasi pala e tretë nuk e ka paguar kredinë, banka ka filluar procedurat e përmbarimit. Së treti, vendimi gjyqësor për heqjen e statusit si hipotekë mbetet i pazbatuar, pasi prona mbetet e shënuar si hipotekë. Së katërti, përpjekjet e parashtruesit të ankesës për ta regjistruar atë me status të rregullt kanë qenë të pasuksesshme.
71. Si pasojë, gjendja e pasigurisë ligjore ka vënë të drejtat e parashtruesit të ankesës në rrezik.
72. Prandaj ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pronës së tij.

Përfshirja e EULEX-it

73. Paneli pranon deklaratën e ShM se EULEX-i ka qenë i njoftuar në lidhje me këtë rast më 25 qershor 2009, atëherë kur parashtruesi i ankesës i kishte kërkuar prokurorit të EULEX-it në Mitrovicë të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që të sqarohet gjendja juridike e pronës në fjalë, nëse duhej, edhe përmes hetimit penal dhe ndjekjes penale.
74. Paneli merr parasysh faktin se nuk ka asnjë detyrim që prokurori të njoftoj parashtruesin e ankesës për procedurën e duhur në lidhje me rastin civil.
75. Megjithatë, Paneli nuk mund të mos e vërej se nuk është argumentuar, e leje më treguar, se është ndërmarrë ndonjë hap nga shërbimi i prokurorisë së EULEX-it që t'iu qaset në mënyrë efektive gjendjes së parashtruesit të ankesës që nga data 25 qershor 2009.
76. Paneli, duke vlerësuar gjendjen e vështirë në gjykatat e Mitrovicës, nxjerr në përfundim se, megjithatë, ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të ankesës për të pasur qasje në gjykatë sipas Nenit 6 § 1 të Konventës dhe një shkelje të së drejtës së tij për gëzimin e qetë të pasurisë së tij të garantuar sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.
77. Përveç kësaj, meqë u përmend, Paneli vë në dukje se procedurat civile në lidhje me pronën në fjalë deri më tani kanë mbetur pezull që prej më shumë se pesë vite, pra prej shkurtit të vitit 2006. Një kohëzgjatje e tillë e procedurës nuk mund të cilësohet se është në

përputhje me të drejtën e parashtruesit të ankesës që rasti i tij të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm të garantuar sipas Nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të zbatueshme në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, me shumicën e votave,
Ë

SHPALL ankesat në lidhje me procedurat civile në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, dhe në lidhje me procedurat penale para prokurorit të EULEX-it, të pranueshme,

KONSTATON se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe një shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të kësaj Konvente,

SHPALL se duke marrë parasysh gjetjet e fakteve të cekura më lart dhe ligjin, është e duhur që të rekomandohet ShM, dhe

REKOMANDON VEPRIMET KORRIGJUESE SI NË VIJIM:

ShM duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për largimin e gjendjes së pasigurisë që është duke ndikuar në gëzimin e qetë të pronësisë nga parashtruesi i ankesës, në veçanti duke vepruar si në vijim,

- të shqyrtoj nëse kushtet për rastin civil, i cili është marrë përsipër nga gjykatësit e EULEX-it, të saktësuar në Nenin 5 paragrafi 1 (c) (ii) ose (iii) i Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, janë plotësuar;
- të jep arsyet për çka duket se nuk ka pasur përparim në hetimin që ishte hapur nga prokurori i EULEX-it, si pasojë e kërkesës së parashtruesit të ankesës së datës 25 qershor 2009;
- për më tepër, të shqyrtoj nëse, në rrethanat e rastit të parashtruesit të ankesës, kushtet e nevojshme janë plotësuar që kompetenca dytësore e prokurorit të EULEX-it të zbatohet; dhe
- të shqyrtohet se çfarë hapa mund të ndërmerren me ndihmën ose përfshirjen e EULEX-it në mënyrë që të sigurohet zbatimi përfundimtar i vendimit gjyqësor i datës 11 dhjetor 2007.

ShM ftohet të njoftoj Panelin dhe parashtruesin e ankesës rreth masave që janë ndërmarrë, dhe rreth rezultateve që kanë dalë prej tyre, jo më vonë se data 31 tetor 2011.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio Balsamo
Kryesues